



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi	Datë: 25/02/2019	Numri i seancës për këtë çështje:
---	-------------------------	--

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Petrit Çeno</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Ish-Kryetar i Gjykatës së Apelit të Durrësit</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Pas 4 orësh, kohëzgjatje e seancës dëgjimore, shqyrtimi të çështjes dhe paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga përfaqësuesit ligjore te subjektit, trupi gjyqes vendosi të shtyjë pas dy ditësh seancën e radhës.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës, pasi trupi gjyqes caktoi datën 27 shkurt për shpalljen e tij.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Trupa gjyqese (emrat)	<i>Lulzim Hamitaj (Kryetar); Etleđa Çiftja (relatore); Olsi Komici (anëtar)</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Branko Hrvatin</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Subjekti i rivlerësimit, nuk u paraqit në seancë, por u përfaqësua nga avokatet Gloria Çeno (e bija e subjektit) dhe Rafik Gurra.</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Dafina Zeneli</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Rreth 12 persona ndoqën seancën. Mes tyre edhe përfaqësues të Avokatit të Popullit.</i>
Media e pranishme:	<i>Për seancën u shfaq interes nga disa media. Ishin të pranishëm gazetarë dhe operatorë të disa televizioneve dhe portaleve.</i>

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi të kryejë vlerësimin vetëm për kriterin pasuror.</i>	<i>Relatorja e çështjes, që në hyrje të seancës theksoi se pavarësisht faktit se subjekti është pezulluar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, KPK vendosi të kryejë hetimet për kriterin pasuror. Por trupi gjyqes nuk bëri ndonjë shpjegim për mos rivlerësimin në dy kriteret e tjera.</i>	<i>Seanca është karakterizuar nga debate dhe kundërshti të përfaqësuesve ligjore të subjektit. Çeno dhe Gurra pretenduan për standarde të dyfishta gjykimi. Avokatja Çeno theksoi se po denigrohet figura e gjyqtarit dhe se sipas saj nuk jemi në kushtet e një rivlerësimi në funksion të reformës. Ata theksuan se nuk ishin pajisur me dosjen e plotë të hetimit dhe rezultateve të tij, por ndërkohë konfirmuan se ishin vënë në dijeni të përfundimit të hetimeve me anë të postës elektronike me 30 janar. Mungesën e akteve, ata e cilësuan si cënim të dy parimeve: për një proces të rregullt ligjor si edhe parimit të barazisë së armëve. Por trupi gjyqes kundërshtoi, duke theksuar se subjekti i rivlerësimit kishte 10 ditë kohë për t'u njohur me dosjen, duke nisur nga data 30 janar, por nuk e ka ushtruar këtë të drejtë.</i>

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	<p>Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, u administrua raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit, në fund ILDKPKI konstatoi se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Deklarimi mbi pasurinë nuk është i saktë 2. Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë 3. Ka kryer fshehje të pasurisë 4. Ka kryer deklarim të rremë 	ILDKPKI	Subjektit iu kalua nga KPK, barra e provës, në përgjigje të rezultateve të hetimit të komisionit lidhur me pasurinë.
	<p>Pasuria e subjektit të rivlerësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një apartament 98 m2, blerë në vitin 2003, në Golem, me vlerë 1,960,000 lekë • Një garazh 22m2, blerë në vitin 2003, në Golem, me vlerë 460,000 lekë • Një apartament 144m2, blerë në vitin 2009, në Tiranë, me vlerë 172,500 euro • Një garazh, blerë në vitin 2009, në Tiranë, me vlerë 24 mijë euro • Dy ullishte në Shkallnuer me sipërfaqe; 3 mijë m2 dhe 2,775 m2; si edhe një godinë shumëkatëshe në ullishte • Një apartament 91.5 m2 në Golem, i shitur më pas si sipërfaqe 81.5m2 (Çeno sqaroi se në shitje nuk është shënuar pjesa e përbashkët, pasi të tillë e ka kërkuar blerësi) • Një automjet tip Renault, me vlerë 18.500 mijë euro 	KPK	
	<ul style="list-style-type: none"> • KPK konkludoi në fund të hetimit, se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarim; nuk ka burime të ligjshme, ka deklarata kontradiktore; • nuk ka dokumentuar të ardhurat e bashkëshortes deri në vitin 1997, një pjesë e të cilave ishin burim për blerjen e apartamentit të parë; • Mungon dokumenti ligjor për kalimin e kredisë 80 mijë euro (marrë nga 2 bashkëshortët dhe djali i tyre) tek kompania H.I ShPK, ku djali i subjektit ishte aksioner. • KPK evidentoi se nuk janë deklaruar aksionet e djalit të subjektit E. Ç., i cili ishte aksioner në 5 kompani. • Komisioni ngriti dyshime për mos deklarim të një pasurie, konkretisht një tarrace prej 150 m2, e kthyer më pas në papafingo. • KPK ngriti dyshime edhe për mënyrën e përfitimit nga ana e bashkëshortes së subjektit të dy ullishteve në Shkallnuer, si edhe konfliktin e interesit me kompaninë e kontraktuar për ndërtimin e godinës shumëkatëshe, ku sipas kontratës bashkëshortja e subjektit, përfitonte 23% të objektit të ndërtuar. Sipas KPK-së rezultoi se gjyqtari, nuk ka hequr dorë nga gjykimi i një çështjeje ku ishte palë, sipërmarrësi i lartpërmendur. • Komisioni evidentoi mospërputhje edhe për 17,200 euro të deklaruara për shkollimin e vajzës së subjektit në Londër. 	KPK	

	<p>Gloria Çeno që përfaqësoi të atin (subjekt i rivlerësimit) si edhe avokati Rafik Gurra, i cilësuan konstatimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si të pasakta dhe të padrejta. Çeno theksoi se ka mungese dokumentacioni, por jo të burimeve të ligjshme. Avokati Gurra, madje pretendoi se gjykata e cilësoi si parazitë bashkëshorten e subjektit, për shkak se deri në vitin 1997 të ardhurat e saj ishin zero. Trupi gjyqës argumentoi se konstatimi vinte pas vlerësimit të dokumenteve dhe nëse dispononin të tjerë, mund t'i paraqisnin.</p> <p>Avokatja u shpreh se të ardhurat e Znj. Çeno deri në vitin 1997 nga puna e saj si agjente doganore, shkojnë në 6.2 milionë lekë, por se nuk arrijnë ta dokumentojnë për shkak se nuk u janë përgjigjur institucionet vendore në Durrës. Duke theksuar se balanca negative e pasurisë së subjektit, prej 3.4 milionë lekësh, vinte pikërisht nga të ardhurat e pa dokumentuara të bashkëshortes, Çeno ri përsëriti kërkesën ndaj trupit gjyqës që ky i fundit të investohet për marrjen e dokumentacionit që vërteton të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, deri në vitin 1997. Megjithatë gjykata theksoi se bën hetim kryesisht si edhe vlerësimin, por jo gjithçka kërkon subjekti. Në mungesë të dokumenteve, avokatja i kërkoi gjykatës të trajtojë rastin si çështja "Prela", duke kërkuar të shërbejë si precedent. Lidhur me përfitimim e ullishteve në Shkallnuer nga bashkëshortja e subjektit, gjykata drejtoi pyetje se me çfarë statusi e ka përfitur tokën bujqësore Znj. Çeno, dhe nëse ajo ose familjarë të saj kanë jetuar në Shkallnuer, duke e cilësuar si një nga kriteret për të përfitur tokën bujqësore. Por nga avokatët u cilësua si pyetje tendencioze.</p> <p>Avokatja Çeno, e bija e subjektit, u shpreh se nuk kanë jetuar në Shkallnuer por se nëna e saj e ka përfitur tokën si punonjëse e administratës bujqësore, konkretisht në detyrën e ekonomistes.</p>	Përfaqësuesit ligjorë	
<p>D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar</p>	<p>Nuk u rivlerësua ky kriter.</p>	KPK	
<p>D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës</p>	<p>Nuk u rivlerësua ky kriter.</p>	KPK	<p>Përfaqësuesit e subjektit, nënvizuan se Çeno ka një karriere 28-vjeçare,ndërkohë që pavarësisht kësaj, është vendosur vetëm rivlerësimi i një kriteri, atij pasuror.</p>
<p>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</p>	<p>Gjatë seancës që zgjati për 4 orë (me një ndërprerje 10 minutëshe për shkak të problemeve me foninë), nuk munguan debatet. Nga ana e trupit gjyqës, gjatë seancës dëgjimore u respektua parimi i procesit të rregullt ligjor dhe barazisë së armëve. Përkundër pretendimit të përfaqësuesve ligjore, se nuk ishin pajisur me dosjen e plotë të hetimit dhe rezultateve nga KPK-ja, rezultoi se kishin marrë djeni nga komisioni për përfundimin e procesit. Por subjekti nuk e kishte ushtruar të drejtën, duke dërguar një listë me 14 kërkesa në KPK. Trupi gjyqës theksoi se çdo subjekt pasi vihet në djeni për përfundimin e hetimit, brenda 10 ditëve, paraqitet pranë ambienteve të KPK-se, ku kërkon të njihet apo të marrë kopje të dosjes dhe se kjo e fundit nuk dërgohet me postë elektronike. Edhe pse përfaqësuesit ligjorë, nuk paraqitën dokumente të reja, përveç atyre që ishin depozituar më parë pranë KPK-së, trupi gjyqës u dha mundësinë që për afro dy orë të paraqesin kundërshtimet dhe konkluzionet përfundimtare. Ndër të tjera, ata pretenduan se po gjykohet me standarde të dyfishta në KPK. Trupi gjyqës ka vepruar konform procedurave ligjore të përcaktuara dhe rregullave të etikës. Ne lidhe me parimin e publicitetit të gjyqimit, rezultoi se është respektuar. Të dhënat për trupin gjyqës, po ashtu data, vendi dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPK-së. Ambienti ku zhvillohet seanca ishte i aksesueshëm dhe lehtësisht i gjindshëm. Seanca ishte e hapur për këdo të interesuar, pasi shënonte gjeneralitetet në hyrje të sallës. Mediat kishin hapësirën e nevojshme, për ndjekjen e seancës. Bazuar në rregulloren e KPK-së, kamerat u lejuan të xhironin vetëm gjatë hapjes së seancës, ndërsa më pas ajo mund të ndiqej vetëm nga gazetarët, që u lejuan të komunikonin përmes sms-ve me redaksitë. Në përfundim avokatët mbrojtës kërkuan të ri shihet gjithë vlerësimi financiar, duke pretenduar se ka pasaktësi dhe është i padrejtë. Ish kreu i Gjykatës së Apelit të Durrësit, është nën hetim nga viti 2015, pasi akuzohet se së bashku me dy gjyqtare të tjerë, kanë përfitur një udhëtim falas për të parë ndeshjen e futbollit mes ekipeve, Barcelona dhe Real Madrid. Ndërsa një vit më parë, u pezullua edhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.</p>		